

URDHËR
Nr. 98, datë 30.12.2024

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 21 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; dhe të nenit 24 të rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”; si dhe në zbatim të vendimit nr. 110/2024 të Kuvendit të Shqipërisë, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; si dhe të ligjit nr. “Për arkivat në RSH”, të ndryshuar; si dhe aktit normativ nr. 5/2024, datë 19.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit te Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, z. Edmond Verçani:

a) për nënshkrimin e urdhrave të përbashkët të kalimit kapital me titullarët e institucioneve për njësitë publike përfituese, të aktiveve dhe aseteve të blera me fondet buxhetore ndër vite nga KPK-ja;

b) për kryerjen e veprimeve brenda afatit të caktuar nga akti normativ nr. 5/2014, datë 19.12.2024, të Këshillit të Ministrave;

c) për nënshkrimin e inventarëve të fondit të dokumenteve që do të dorëzohen për arkivim sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, si dhe dy drejtoritë në varësi të tij, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Zyra e Protokoll-Arkivit së KPK-së për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Roland Ilia